



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ prot.
_____._____2026

Vlorë, më

PROCES VERBAL

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – E Hapur, Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti: Shpenzime per dekorimin e festave te fundvitit

FONDI LIMIT: 12,396,500 (Dymbedhjete milion e treqind e nentedhjete e gjashte mije e peseqind) leke pa tvsh

Kodi CPV: Dekorime -45451000-3

Tipi i Proçedurës: E hapur, Mallra

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vlore** ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenet 76 dhe 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83/1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Si dhe Nenit 83/2 ku përcaktohet se: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit**

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se:

Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Xhiroja vjetore minimale parashikuar të kontratës; në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b)vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepërmjet dokumenteve të kërkuara më poshtë, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në pikën 1 dhe pikën 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Duke qenë se kjo procedure prokurimi bazuar në vlerën e fondit limit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025, të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009, **“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”**, bilancet duhet të shoqërohen edhe me **raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore**, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese, sipas përcaktimeve ligjore. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur referuar nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe demonstron se Operatori Ekonomik ka aftësi financiare për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të kërkuar cilësie. Njësia e Prokurimit gjykon të nevojshme vendosjen e kriterit që operatorët ekonomikë të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve **2023, 2024 dhe 2025**, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, me qëllim verifikimin e gjendjes dhe qëndrueshmërisë së tyre financiare. Paraqitja e pasqyrave financiare për tre vitet e fundit ushtrimore shërben për të vlerësuar vazhdimësinë e aktivitetit ekonomik dhe aftësinë e operatorit për të përballuar angazhimet financiare që lidhen me realizimin e kontratës. Ndërkohë, kërkesa që, në rastet kur operatori ekonomik ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 41 të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, bilancet të shoqërohen me raportet e auditimit ligjor, synon garantimin e besueshmërisë dhe korrektësisë së informacionit financiar të paraqitur. Kërkesa për paraqitjen e raportit të auditimit ligjor, në rastet kur operatori ekonomik është subjekt i përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009, synon të garantojë **besueshmërinë dhe verifikueshmërinë e informacionit financiar** të paraqitur nga operatori ekonomik, mbi bazën e të cilit Autoriteti Kontraktor vlerëson kapacitetin e tij ekonomik dhe financiar. Kjo kërkesë nuk vendos një detyrim shtesë për operatorët ekonomikë që nuk janë subjekt i auditimit të detyrueshëm, por kërkon respektimin e detyrimit ligjor për auditimin e pasqyrave financiare në ato raste kur ky detyrim parashikohet nga legjislacioni në fuqi. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse, në **dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara**, nuk rezulton një raport negativ ndërmjet

aktivitet dhe pasivitet. Ky përcaktim synon të sigurojë që operatori ekonomik të mos paraqesë një gjendje të paqëndrueshme financiare për një periudhë të vazhdueshme, e cila mund të ndikojë në aftësinë e tij për të realizuar detyrimet kontraktore. Për rrjedhojë, kriteri është vendosur në funksion të verifikimit të kapacitetit ekonomik dhe financiar të operatorëve pjesëmarrës, duke garantuar që operatori fitues të disponojë një gjendje financiare të përshtatshme për realizimin e kontratës, pa krijuar kufizime të panevojshme ose diskriminuese ndaj pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit. Gjithashtu, përcaktimi që kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në **dy bilanci e njëpasnjëshme të kërkuara nuk rezultojn raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet**, ka për qëllim të verifikojë që operatori ekonomik disponon një **pozicion financiar të qëndrueshëm**, ku aktivitet janë në gjendje të mbulojnë detyrimet e tij. Ky tregues shërben si një element objektiv për të vlerësuar aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorit ekonomik për përmbushjen e kontratës. Në këtë mënyrë, kriteri është vendosur në funksion të garantimit të një procesi prokurimi të sigurt dhe të besueshëm, duke mundësuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që paraqesin **kapacitet financiar të mjaftueshëm dhe qëndrueshmëri ekonomike**, pa krijuar kufizime të panevojshme ose joproporcionale ndaj konkurrencës.

2.2.3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për këstet e maturuara të vitit 2026 (sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore është përcaktuar me qëllim **verifikimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe fiskale** nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Kjo kërkesë lidhet me detyrimin e operatorëve ekonomikë për të përmbushur detyrimet e tyre ndaj njësitë të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e taksave vendore, dhe shërben si element verifikues i gjendjes së tyre administrative dhe fiskale. Kërkesa është e lidhur me përgjegjësinë e operatorit ekonomik për përmbushjen e detyrimeve fiskale që kanë arritur afatin e pagesës dhe shërben për të siguruar që operatori ekonomik pjesëmarrës të jetë në përputhje me detyrimet e tij ligjore vendore. Përcaktimi i detyrimeve për **këstet e maturuara të vitit 2026**, sipas të dhënave të QKB-së, synon që verifikimi të lidhet me detyrimet aktuale të operatorit ekonomik dhe me njësitë të vetëqeverisjes vendore në të cilat ai ushtron aktivitetet. Përfshirja e këtij kriteri është në përputhje me kërkesat ligjore dhe synon të sigurojë që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të jenë në përmbushje të detyrimeve të tyre vendore. Për rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, kërkesa ndaj çdo anëtar është e nevojshme për të verifikuar përmbushjen individuale të detyrimeve ligjore nga secili anëtar i grupit.

2.3. Për kapacitetin teknik: Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin parashikohet se:

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se:

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Kërkesa për paraqitjen e dëshmive për furnizime të mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë **3 (tre) viteve të fundit**, në një vlerë jo më të vogël se **40% e fondit limit**, është përcaktuar me qëllim verifikimin e **kapacitetit teknik dhe profesional** të operatorit ekonomik për realizimin me sukses të furnizimeve objekt të kësaj procedure. Kërkesa për furnizime të ngjashme lidhet me natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin furnizimin, transportimin dhe montimin e elementeve dekorative, dhe synon të sigurojë që operatori ekonomik ka realizuar më parë furnizime të një natyre dhe kompleksiteti të krahasueshëm. Vlera e kërkuar prej **40% të fondit limit** është përcaktuar në mënyrë proporcionale me vlerën dhe kompleksitetin e kontratës, me qëllim që operatori ekonomik të dëshmojë një nivel të mjaftueshëm eksperience të mëparshme, pa u kërkuar të ketë realizuar kontrata me vlerë të barabartë me objektin e prokurimit.

Kufizimi i periudhës së referencës në **3 vitet e fundit** siguron që përvoja e paraqitur të jetë relevante dhe relativisht e fundit, duke dhënë një tregues më të përshtatshëm mbi aftësinë aktuale të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën. Kërkesa që furnizimet e ngjashme të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve të lëshuara nga entet publike dhe/ose faturave tatimore të shitjes, të deklaruara pranë organeve tatimore, synon të sigurojë **verifikueshmërinë, realitetin dhe vlerën e furnizimeve të deklaruara**. Përcaktimi i periudhës së referencës prej 3 (tre) vitesh nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës synon të sigurojë që përvoja e paraqitur të jetë **e kohëve të fundit dhe relevante** për realizimin e objektit të prokurimit.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht 5 (pesë) punonjës/personel të angazhuar për realizimin e objektit të prokurimit, të përshtatshëm për furnizimin, transportimin, montimin dhe vendosjen e elementeve dekorative, si më poshtë:

- **1 (një) dizenjator, përgjegjës për përshtatjen dhe organizimin estetik të elementeve dekorative, në përputhje me specifikimet teknike dhe materialin ilustrues të përcaktuar në dokumentet e tenderit;**
- **2 (dy) montues, për montimin, vendosjen dhe fiksimin e elementeve dekorative, të certifikuar për kryerjen e punimeve në lartësi;;**
- **2 (dy) punonjës, për transportimin, ngarkim-shkarkimin e materialeve dhe elementeve dekorative, si dhe për asistencën gjatë procesit të montimit**

Për personelin e mësipërm, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin, si:

- **Dokument që provon marrëdhënien e punës ose angazhimin e personelit me operatorin ekonomik;**
- **Për dizenjatorin, dokument që provon angazhimin e tij në këtë funksion, si dhe dokumentacionin përkatës që dëshmon kualifikimin/profilin profesional të kërkuar;**
- **Për 2 (dy) montuesit, dokumentacion që provon trajnimin e tyre për kryerjen e punimeve në lartësi;**

- Vërtetim të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve të operatorit ekonomik për 3 (tre) muajt e fundit;
- Listëpagesat e punonjësve, sipas formatit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi, për 3 (tre) muajt e fundit.

Argumentim: Ky kriter, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

.Kërkesa për disponimin e minimalisht **5 (pesë) punonjësve/personelit të angazhuar** është përcaktuar në përputhje me natyrën dhe kërkesat teknike të objektit të prokurimit, i cili përfshin jo vetëm furnizimin e elementeve dekorative, por edhe **transportimin, ngarkim-shkarkimin, montimin, vendosjen dhe fiksimin e tyre** në hapësirat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa për **1 (një) dizenjator** lidhet me natyrën dekorative të objektit dhe nevojën për përshtatjen dhe organizimin estetik të elementeve të furnizuara, në përputhje me specifikimet teknike, konfigurimin e kërkuar dhe materialin ilustrues të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Kërkesa për **2 (dy) montues** është e nevojshme për realizimin e proceseve të montimit, vendosjes dhe fiksimit të elementeve dekorative. Kjo kërkesë lidhet veçanërisht me faktin se një pjesë e elementeve do të vendosen në **shtyllat ekzistuese dhe në pozicione me lartësi të konsiderueshme**, duke kërkuar kryerjen e punimeve në lartësi. Për këtë arsye, kërkesa që montuesit të jenë **të certifikuar për kryerjen e punimeve në lartësi** synon garantimin e realizimit të punimeve nga personel me kualifikimin/trajnimin e nevojshëm për këtë lloj pune dhe në kushte të përshtatshme sigurie.

Kërkesa për **2 (dy) punonjës** të angazhuar për transportimin, ngarkim-shkarkimin dhe asistencën gjatë montimit lidhet me nevojën për manipulimin dhe pozicionimin e elementeve dekorative, materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e punimeve. Ky personel mundëson mbështetjen e procesit të montimit dhe organizimin e njëkohshëm të proceseve të transportit dhe instalimit.

Përcaktimi i këtij numri dhe ndarja e funksioneve është bërë duke marrë në konsideratë **volumin dhe shumëllojshmërinë e elementeve dekorative**, përmasat e disa prej tyre, nevojën për montim në lartësi dhe kërkesën për realizimin e furnizimit, transportit dhe montimit brenda afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit që provon marrëdhënien e punës ose angazhimin e personelit synon të verifikojë disponueshmërinë reale të burimeve njerëzore të deklaruara nga operatori ekonomik. Dokumentacioni specifik për dizenjatorin dhe montuesit synon të verifikojë përkatësisht **profilin/funksionin profesional dhe certifikimin për punime në lartësi** të personelit përkatës. Kërkesa për vërtetimin e numrit të punonjësve dhe listëpagesat për **3 (tre) muajt e fundit** synon të sigurojë një verifikim objektiv të kapacitetit njerëzor të operatorit ekonomik dhe të mundësojë vlerësimin e disponueshmërisë së personelit të deklaruar për realizimin e kontratës.

Në tërësi, ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me kërkesat e objektit të prokurimit dhe synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë **kapacitetin njerëzor të nevojshëm për realizimin e plotë, të sigurt dhe në kohë të furnizimit, transportimit, montimit dhe vendosjes së**

elementeve dekorative, pa vendosur kërkesa që nuk lidhen me natyrën dhe nevojat reale të kontratës.

2.3.3 Mjetet dhe pajisjet teknike

Operatori ekonomik duhet të disponojë, në pronësi ose me qira, ose t'i jenë vënë në dispozicion për realizimin e kontratës, minimalisht mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

a) **Kamionçinë me kapacitet deri në 3.5 ton** – 1 (një) copë, për transportimin e materialeve, pajisjeve dhe mbetjeve të krijuara gjatë realizimit të kontratës;

b) **Platformë ajrore me lartësi pune jo me pak se 18 m** – 1 (një) copë, për realizimin e punimeve në lartësi.

Dokumentet provuese:

- për mjetet në pronësi, dokumentin që provon pronësinë dhe dokumentet e vlefshme të regjistrimit të mjetit;
- për mjetet me qira, kontratën e qirasë të vlefshme dhe dokumentet e mjetit;
- për mjetet/pajisjet e vëna në dispozicion nga një subjekt tjetër, dokumentin që provon vënien në dispozicion të tyre dhe dokumentet përkatëse të mjetit/pajisjes;
- për mjetet që regjistrohen në regjistra publikë, dokumentet e vlefshme të regjistrimit dhe përdorimit, sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë, sipas rastit, **lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit dhe dokumentin për pagesën e taksave**;
- për platformën ajrore, **dokumentacionin teknik** që provon karakteristikat dhe lartësinë e punës së saj.

Argumentimi: Ky kriter, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa për disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike është përcaktuar në funksion të natyrës së objektit të prokurimit, i cili përfshin **furnizimin, transportimin, montimin dhe vendosjen e elementeve dekorative dhe ndriçuese** në ambientet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa për **1 (një) kamionçinë me kapacitet deri në 3.5 ton** është e nevojshme për transportimin e elementeve dekorative, materialeve dhe pajisjeve nga vendi i furnizimit deri në vendet e përcaktuara për montim, si dhe për transportimin e mbetjeve të krijuara gjatë procesit të montimit. Kërkesa për një mjet të tillë lidhet me nevojën për realizimin e transportit në mënyrë të organizuar dhe brenda afatit të përcaktuar për realizimin e kontratës.

Kërkesa për **1 (një) platformë ajrore me lartësi pune jo më pak se 18 m** është e nevojshme për realizimin në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme të montimit dhe vendosjes së elementeve dekorative dhe ndriçuese në lartësi, veçanërisht për elementet që vendosen në shtylla dhe struktura të tjera të larta, si elementet dekorative tematike për shtylla, elementet në formë ylli me ndriçim dhe elemente të tjera të parashikuara në preventiv.

Përcaktimi i lartësisë së punës **jo më pak se 18 m** lidhet me nevojën për të garantuar aksesin në lartësinë e kërkuar për montimin e elementeve të parashikuara në objekt, duke mundësuar realizimin e punimeve në mënyrë të sigurt dhe në përputhje me kërkesat teknike. veçanërisht të dekorimeve që vendosen në shtyllat ekzistuese dhe të elementeve me përmasa të mëdha. Kjo pajisje mundëson realizimin e punimeve në lartësi në kushte të përshtatshme sigurie dhe siguron kapacitetin teknik të nevojshëm për realizimin e objektit.

Kërkesa që mjetet dhe pajisjet të mund të disponohen **në pronësi, me qira ose të vihen në dispozicion nga një subjekt tjetër** siguron fleksibilitet për operatorët ekonomikë dhe nuk kufizon mënyrën e sigurimit të kapaciteteve teknike, duke garantuar njëkohësisht që mjetet dhe pajisjet e kërkuara të jenë në dispozicion për realizimin e kontratës. Dokumentacioni i kërkuar synon të verifikojë **ekzistencën, disponueshmërinë dhe përshtatshmërinë teknike** të mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara nga operatori ekonomik.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë, për artikujt e ofertuar, katalogë, fletë teknike, materiale fotografike dhe/ose dokumentacion tjetër teknik të prodhuesit ose furnizuesit, në të cilin të identifikohen qartë karakteristikat teknike dhe funksionale të produkteve të ofruara. Dokumentacioni teknik duhet të jetë i mjaftueshëm për të mundësuar verifikimin e përputhshmërisë së produkteve të ofruara me **specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit**, përfshirë përmasat, materialet, strukturën, karakteristikat e ndriçimit, mënyrën e përdorimit dhe kërkesat për përdorim në ambiente të jashtme. Për produktet, komponentët ose materialet për të cilat parashikohet nga legjislacioni në fuqi, standardet përkatëse ose dokumentacioni teknik i prodhuesit, operatori ekonomik duhet të paraqesë, sipas rastit, **certifikatë cilësie, deklaratë konformiteti dhe/ose dokument tjetër të vlefshëm që dëshmon përputhshmërinë e produktit me kërkesat teknike, të sigurisë dhe të cilësisë.**

Për **komponentët elektrikë dhe sistemet e ndriçimit LED** të përdorura në elementet dekorative, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion teknik dhe, sipas rastit, **deklaratë konformiteti, certifikatë cilësie ose dokument tjetër të vlefshëm të prodhuesit,** nëpërmjet të cilit të verifikohet përputhshmëria e tyre me kërkesat teknike dhe të sigurisë të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Dokumentacioni duhet të mundësojë, ndër të tjera, verifikimin e përshtatshmërisë së komponentëve për **përdorim në ambiente të jashtme** dhe të nivelit të mbrojtjes së kërkuar, përfshirë **IP65 ose ekuivalent**, kur kjo kërkesë është përcaktuar në specifikimet teknike.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të lejojë identifikimin e **prodhuesit, modelit ose tipit të produktit/komponentit**, kur këto të dhëna janë të aplikueshme, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të mund të verifikojë përputhshmërinë e ofertës me kërkesat teknike të dokumenteve të tenderit.

Në rast se dokumentacioni teknik është në gjuhë të huaj, ai duhet të shoqërohet me **përkthimin përkatës në gjuhën shqipe**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 1, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të dorezojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si fotografitë apo katalogët teknikë .Kërkesa për paraqitjen e **katalogëve, fletëve teknike, materialeve fotografike dhe/ose dokumentacionit tjetër teknik të prodhuesit ose furnizuesit** është përcaktuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësi të verifikojë në mënyrë objektive përputhshmërinë e produkteve të ofertuar me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Objekti i prokurimit përfshin elemente dekorative të ndryshme, me karakteristika dhe përmasa të ndryshme, të cilat përbëhen nga struktura metalike, materiale dekorative dhe sisteme ndriçimi. Për këtë arsye, dokumentacioni teknik është i nevojshëm për të identifikuar karakteristikat e produkteve të ofruara dhe për të verifikuar përputhshmërinë e tyre me kërkesat e përcaktuara për materialet, strukturën, përmasat, mënyrën e ndërtimit, funksionalitetin dhe përdorimin në ambiente të jashtme.

Kërkesa për **certifikatë cilësie, deklaratë konformiteti dhe/ose dokument tjetër të vlefshëm**, sipas rastit, synon të sigurojë që produktet dhe komponentët e ofruar përmbushin kërkesat teknike, të sigurisë dhe të cilësisë që zbatohen për to. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për komponentët elektrikë dhe sistemet e ndriçimit, pasi këto elemente do të përdoren në **ambiente të jashtme dhe hapësira publike**, ku duhet të garantohej funksionimi i sigurt dhe i përshtatshëm i instalimit. Për **komponentët elektrikë dhe ndriçimin LED**, dokumentacioni teknik dhe dokumentacioni i konformitetit mundësojnë verifikimin e karakteristikave të kërkuara, përfshirë përshtatshmërinë për përdorim në ambiente të jashtme dhe nivelin e mbrojtjes së përcaktuar në specifikimet teknike, si **IP65 ose ekuivalent**. Kjo kërkesë lidhet me nevojën për mbrojtjen e komponentëve nga kushtet atmosferike dhe për garantimin e përdorimit të sigurt të elementeve të ndriçimit gjatë periudhës së dekorimit. Kërkesa që dokumentacioni të identifikojë, kur është e aplikueshme, **prodhuesin, modelin ose tipin e produktit/komponentit**, mundëson një verifikim më të saktë të produktit konkret të ofertuar dhe shmang situatat në të cilat karakteristikat e deklaruara nuk mund të kontrollohen në mënyrë objektive. Pranimi i **dokumenteve ekuivalente dhe dokumentacionit të ndryshëm teknik të vlefshëm**, sipas natyrës së produktit, synon të shmangë kufizimin e panevojshëm të konkurrencës dhe lejon operatorët ekonomikë të dëshmojnë përputhshmërinë e produkteve të tyre nëpërmjet dokumenteve të përshtatshme. Në rastin e dokumentacionit në gjuhë të huaj, kërkesa për përkthimin në gjuhën shqipe është përcaktuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të mund të shqyrtojë dhe verifikojë në mënyrë të plotë karakteristikat teknike dhe dokumentacionin e konformitetit të produkteve të ofertuar.

Në tërësi, ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me natyrën e objektit dhe synon të sigurojë **verifikueshmërinë, cilësinë, sigurinë dhe përputhshmërinë teknike të produkteve të ofertuar**, veçanërisht të komponentëve elektrikë dhe sistemeve të ndriçimit që do të përdoren në ambiente të jashtme dhe hapësira publike.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon kapacitetet e nevojshme teknike, njerëzore dhe organizative për furnizimin, transportimin, montimin dhe vendosjen në funksionim të elementeve dekorative, në përputhje me specifikimet teknike dhe brenda afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Kërkesa që operatori ekonomik të deklarojë disponimin e kapaciteteve të nevojshme teknike, njerëzore dhe organizative lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit, i cili përfshin jo vetëm furnizimin e elementeve dekorative, por edhe transportimin, montimin dhe vendosjen e tyre në funksionim.

Disponimi i këtyre kapaciteteve është i nevojshëm për të garantuar realizimin e plotë dhe në kohë të objektit të prokurimit, në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për elementet dekorative që kërkojnë transport, pozicionim, montim dhe instalim në ambiente të ndryshme. Kërkesa për deklarimin e kapaciteteve synon gjithashtu të sigurojë që operatori ekonomik të jetë në gjendje të organizojë dhe të përfundojë të gjitha fazat e realizimit brenda afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit, duke garantuar funksionalitetin dhe vendosjen e elementeve dekorative sipas kërkesave teknike. Kriteri është i lidhur dhe proporcional me objektin e prokurimit, pasi nuk përcakton kapacitete të panevojshme apo të veçanta, por kërkon vetëm konfirmimin e disponimit të kapaciteteve të nevojshme për realizimin e detyrimeve që burojnë nga objekti i kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë vendosur nga grupi i pune i krijuar për hartimin e e projektit ,preventivit, afatit të punimeve dhe relacionin teknik , në përputhje me nenin 4,pika 7, 38, nenin 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 40, pika 2, të V.K.M-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
Specifikimet teknike gjenden bashkëngjitur D.S.T-ve në S.P.E

Specifikimet teknike janë përcaktuar në përputhje me nevojat e Autoritetit Kontraktor dhe me natyrën e objektit të prokurimit, me qëllim sigurimin e elementeve dekorative të përshtatshme për përdorim në hapësirat publike dhe për realizimin e dekorimeve të festave të fundvitit. Përcaktimi i karakteristikave teknike dhe funksionale të produkteve synon të garantojë cilësinë, qëndrueshmërinë, sigurinë, funksionalitetin dhe paraqitjen estetike të elementeve dekorative, si dhe përshtatjen e tyre me ambientet ku do të vendosen. Specifikimet janë hartuar duke marrë në konsideratë dimensionet, materialet, elementet konstruktive, sistemet e ndriçimit dhe karakteristikat e tjera të nevojshme për secilin artikull të parashikuar në preventiv.

Kërkesat teknike janë të lidhura drejtpërdrejt me funksionin dhe përdorimin e produkteve dhe janë përcaktuar në nivelin e nevojshëm për të mundësuar identifikimin dhe verifikimin e ofertave, pa vendosur kërkesa të panevojshme që mund të kufizojnë konkurrencën.

Në këtë mënyrë, specifikimet teknike synojnë të sigurojnë që produktet e furnizuara të përmbushin nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor, të jenë të përshtatshme për përdorim në ambiente të jashtme dhe të mundësojnë realizimin e dekorimeve sipas konceptit dhe kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Specifikimet teknike të përcaktuara për kete objekti prokurimi janë hartuar në përputhje me nevojat e Autoritetit Kontraktor, karakteristikat e hapësirave publike ku do të vendosen elementet dekorative dhe kërkesat për realizimin e tyre në kushte të përshtatshme sigurie, qëndrueshmërie dhe funksionaliteti. Përcaktimi i karakteristikave teknike për secilin element dekorativ është bërë duke marrë në konsideratë **funksionin, përmasat, mënyrën e konstruksionit, materialet, sistemin e ndriçimit, rezistencën ndaj kushteve atmosferike dhe mënyrën e montimit/fiksimit**. Këto kërkesa synojnë të garantojnë që elementet e furnizuara të jenë të përshtatshme për përdorim në ambiente të jashtme dhe në hapësira publike, duke ruajtur njëkohësisht paraqitjen estetike dhe funksionalitetin gjatë periudhës së përdorimit. Për elementet e ndriçuara është përcaktuar përdorimi i ndriçimit **LED të përshtatshëm për ambiente të jashtme, me nivel mbrojtjeje IP65 ose ekuivalent**, me qëllim garantimin e mbrojtjes së komponentëve elektrikë nga pluhuri dhe depërtimi i ujit, si dhe funksionimin e sigurt të ndriçimit në kushtet atmosferike të ambientit të jashtëm. Kërkesat për komponentët LED dhe elementët mbrojtës janë përcaktuar për të siguruar një ndriçim të njëtrajtshëm, qëndrueshmëri dhe përdorim të përshtatshëm gjatë periudhës së dekorimit. Përcaktimi i **strukturave metalike** për elementet dekorative lidhet me nevojën për të garantuar qëndrueshmëri mekanike, formën e kërkuar të dekorimit dhe mundësinë e montimit dhe fiksimit të sigurt në pozicionet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Për elementet që do të vendosen në shtyllat ekzistuese, specifikimet kërkojnë që ato të jenë të përshtatshme për **fiksim në infrastrukturën ekzistuese**, pa ndryshuar funksionin e saj dhe pa shkaktuar dëmtime në pronën publike. Përmasat e përcaktuara për elementet dekorative janë vendosur në funksion të **hapësirave ku ato do të instalohen, efektit vizual të kërkuar dhe përshtatjes me vendndodhjet konkrete**. Përmasat shërbejnë si kërkesa teknike për të garantuar që elementet të kenë përmasat e nevojshme për përdorimin dhe konfigurimin e parashikuar, duke ruajtur funksionalitetin dhe sigurinë gjatë montimit. Për elementet që shërbejnë si pika fotografimi, si **harku dekorativ dhe korniza Polaroid**, kërkesat teknike janë përcaktuar duke marrë në konsideratë përdorimin e tyre në hapësira publike dhe nevojën për stabilitet, qëndrueshmëri dhe siguri gjatë përdorimit nga qytetarët. Gjithashtu, kërkesat për **transportimin, montimin, vendosjen dhe fiksimin** e elementeve janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën e objektit. Elementet nuk do të konsiderohen të përfunduara vetëm me furnizimin e tyre, por duhet të transportohen dhe të montohen në pozicionet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, duke garantuar stabilitetin, sigurinë dhe funksionalitetin e tyre. Operatori ekonomik duhet të realizojë edhe lidhjet dhe sistemimin e nevojshëm të elementeve të ndriçimit, në mënyrë që instalimi të jetë i përshtatshëm për përdorim në ambiente të jashtme. Në përcaktimin e specifikimeve teknike është synuar që kërkesat të jenë **të qarta, të matshme dhe të verifikueshme**, në mënyrë që të mundësohet vlerësimi objektiv i përputhshmërisë së produkteve të ofruara me nevojat e Autoritetit Kontraktor. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve, fletëve teknike, materialeve fotografike dhe/ose dokumentacionit tjetër teknik shërben pikërisht

për të verifikuar karakteristikat teknike dhe funksionale të elementeve të ofertuar. Specifikimet teknike janë hartuar duke respektuar parimin e proporcionalitetit dhe duke shmangur përcaktimin e kërkesave që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e prokurimit. Referencat teknike për materiale, teknologji apo karakteristika të caktuara interpretohen në mënyrë që të lejojnë **zgjidhje ekuivalente**, kur ato përmbushin të njëjtat kërkesa funksionale dhe teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në përfundim, specifikimet teknike të përcaktuara synojnë të sigurojnë që Autoriteti Kontraktor të marrë elemente dekorative **të përshtatshme për përdorim në ambiente të jashtme, të qëndrueshme, të sigurta, funksionale dhe me paraqitje estetike të përshtatshme**, si dhe që furnizimi, transporti, montimi dhe vendosja e tyre të realizohen në mënyrë të plotë dhe brenda afatit të përcaktuar në dokumentet e tenderit.